



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK



Datë 06/10/2025

PROCES VERBAL

Dëgjesë Publike për Paketën Fiskale 2026, Buxhetin e Bashkisë Përmet 2026,

PBA 2026-2028

Vendi : Njësia Administrative Piskovë, Përmet

Ora : 10:00

Tema e konsultimit : Paketa Fiskale 2026, Buxheti 2026, PBA 2026-2028

I mbajtur sot më datë 6 Tetor, pranë ambienteve të Njesisë Administrative Piskovë. Të pranishëm në këtë konsultim janë Nënkryetari i Bashkisë z.Florand Hasani, Kryetare e Këshillit Bashkiak znj.Anila Dhimitri, Administratori i Njesisë Piskovë, Përgjegjësi i Ujësjetllës Kanalizime Përmet, Kryetarët e Fshatrave dhe banorë të zonës.

Takimi u hap nga znj.Dhimitri e cila si fillim përshëndeti të pranishmit në këtë takim. Gjithashtu theksoi se po zhvillohen takime të vazhdueshme për të konsultuar Buxhetin dhe Paketën Fiskale të vitit të ardhshëm. Këto takime janë mjaft të rëndësishme për të marrë ide e sugjerime nga banorët lidhur me problematikat e zonës.

Më pas fjalën e mori Nënkryetari i cili u tha banorëve se tarifat vendore nuk do të ndryshojnë. E vetmja tarifë që do të ndryshojë është ajo e kullotjes e cila ndryshon si rezultat i një VKM-je.

Në përfundim të fjalës së tij, ai u la fjalën të pranishmëve për të thënë idetë dhe problematikat e zonave të tyre.

Sugjerimet e dala nga ky takim janë :

Fshati Raban

1. Investime për ujin e pijshëm
2. Nevojë për ndërhyrje në rrugën e fshatit

Fshati Kosovë

1. Rruga e fshatit me probleme të mëdha

Fshati Borockë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

1. Probleme me ujësjellësin
2. Probleme me vërshimin e ujit të lumit
3. Nevoja për ndërtimin e një ure midis dy lagjeve

Fshati Piskovë

1. Hapja e rrugëve mes tokave bujqësore
2. Nevoja për një ndërhyrje tek përroi i fshatit

Fshati Rapckë

1. Rruga e fshatit me disa problematika të vogla

Fshati Kutal

1. Rruga drejt varrezave nevojë për ndërhyrje
2. Problematika me ujin e pijshëm

Në fund të këtij takimi z.Hasani dhe znj.Dhimitri i falenderuan të pranishmit për pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e mirë që ekziston mes palëve.

Takimi u mbyll në orën **11:30**.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska



SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Denisa DURRO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Foto nga takimi:

